



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**

**Nr. 66, datë 06.02.2020**

**PËR  
PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR VERIFIKIMIN E  
PLOTËSIMIT TË KRITEREVE LIGJORE TË PRANIMIT NË PROVIMIN E  
PRANIMIT NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK 2020-  
2021, TË KANDIDATËVE PËR KËSHILLTARË DHE NDIHMËS LIGJORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 62, pika 14, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 53, pikat 4/b dhe 9, të Ligjit nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin e tij nr. 62, datë 30.01.2020, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”,

**VENDOSI:**

1. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, është si më poshtë:
  1. Z. Maksim Qoku;
  2. Znj. Marçela Shehu;
  3. Znj. Brunilda Kadi.
2. Anëtarët e Komisionit të Përkohshëm të marrin masat për zbatimin e kërkesave të vendimit nr.62, datë 30.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**